



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKISË VAU-DEJËS



VENDIM
Nr. *08*, date *24*/01/2020

Për

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Vau-Dejë, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për **14** familje, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga tërmeti i dt.26.11.2019 nga Buxheti i Bashkisë i vitit 2020 si dhe Buxheti i Vitit 2020 në Ministrinë e Mbrojtjes ,programi “Mbrojtja Civile”

Baza Ligjore

Ligji Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji për Prefektin Nr.107/2018 Ligji Nr.45/2018 “Për Mbrojtjen Civile , Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.329, datë 16.05.2012 pika 3“Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave Nr.263 datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore , Shkresa Nr.287 dt.14.02.2017 të Qarkut Shkodër “Lidhur me çmimet e zërave të punës për vitin 2016”,

Vëndosi:

1. Të miratojë kërkesat e **14** familjeve të Bashkisë Vau-Dejë për mbështetje financiare të tyre , për dëmtimin e banesave të tyre nga tërmeti i datës 26.11.2019 .
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Vau-Dejë.
3. Ti akordojë **14** familjeve të shtetasve ndihmën emergjente në vlerën prej **5,656,291 lekë** (pesëmilion e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e një) lekë sipas tabelës së poshtëshënuar nga buxheti i Bashkisë Vau-Dejë, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli i Bashkisë me VKB Nr.92 dt.24.12.2019 “Per miratimin e buxhetit 2020”.